



16.12.2025

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVA - MUNICIPALITY OF SUHAREKA			
MARRË NË DORËZIM - PRILMËNJË - RECEIVED			
Njësia org. Org. jedinica Org. Unit	Num. Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
01	016	74879	8

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS -

Më datë 16.12.2025

Kryetari i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenin 9, paragrafi 1, pika 1.1 lidhur me nenin 4, të Udhëzimit Administrativ, Nr.27/2012 MPB - Nr.03/2012 MAPL për këshillat komunal për sigurinë në bashkësi, Kryesuesi i KKSBB-së bënë këtë:

FTESË PUBLIKE

Për propozimet e anëtarëve të rinjë në këshillin komunal për siguri në bashkësi

Ftesa publike bëhet për përfaqësuesit e komuniteteve si më poshtë;

1. Nga një përfaqësues legjitim i secilës bashkësi fetar të Komunës së Suharekës;
2. Nga një përfaqësues të secilit komunitet etnik të Komunës së Suharekës;
3. Kryetari i këshillit të prindërve të arsimit të Komunës së Suharekës;
4. Një përfaqësues i secilit këshill lokal për siguri publike;
5. Kryesuesi i ekipit veprues për siguri në bashkësi;
6. Një përfaqësues nga OJQ-ja;
7. Një përfaqësues nga mediat lokale;
8. Një përfaqësues nga komuniteti biznesit dhe
9. Një përfaqësues nga komuniteti i personave me nevoja te veçanta;

Propozimet me emrat mund t'i dorëzoni në Zyrën e Nr. 1 (zyra e pritës) në Administratën e Komunës në Suharekë me seli në Rr. "Br. 123".

Afati për dërgimin e propozimeve me emra duhet të bëhet brenda 15, (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e shpalljes së ftesës publike në wbefaqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe në tabelën e shpalljeve.

Propozimet e emrave të dërguar pas këtij afati nuk merren parasysh.



Bali MUHARREMAJ

Kryetari i Komunës